



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 386 Prot.

Vlorë, më 08.03.2021

VENDIM

Nr. 5, datë 02.03.2021

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 02.03.2021 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr.429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, si dhe kërkesës së Z. Niko Kacalidha për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonë Nr. 1696 Prot, datë 16.11.2020

VENDOSI;

1.Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Niko Kacalidha, për kontribut të vyer në pasurimin e poezisë shqipe me vlera origjinale të krijimtarisë së tij, si dhe për përkthimin me mjeshtëri nga shqipja në greqisht dhe nga greqishtja në shqip të poetëve shqiptarë dhe atyre grekë.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sektori i Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit të Qarkut